



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.12, 1.14, nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L- 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Rregullores (15/2016) për Transferimin dhe Caktimin e Gjyqtarëve, në mbledhjen e 218-të, të mbajtur me datë 27 maj 2019, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e z. Kushtrim Shyti, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për transferim nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 maj 2019.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 19 prill 2019, ka pranuar një shkresë nga gjyqtari Kushtrim Shyti, përmes së cilës kërkon që t'i mundësohet transferimi nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Arsyen e kërkesës së tij z. Shyti, e mbështet në vështirësitë që i paraqiten në procesin e punës, për shkak të udhëtimit të përditshmën në relacionin Mitrovicë-Prishtinë dhe anasjelltas, meqë i njëjti vendbanimin e përhershëm e ka në Mitrovicë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 27 maj 2019, shqyrtoi kërkesën e gjyqtarit Kushtrim Shyti, të cilën e refuzoi, pasi që i njëjti nuk mund të aplikoj pranë KGJK-së për transferim të përhershëm nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, sepse në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shpallje të konkursit të brendshme për transferim të përhershëm, po ashtu ky transferim nuk mund të bëhet për shkak se gjyqtari është me

mandat fillestar, bazuar në nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Rregullores (15/2016) për Transferimin dhe Caktimin e Gjyqtarëve, ndër kriteret e parapara për transferim të përhershëm të Gjyqtarëve parashihet se gjyqtari duhet të jetë me mandat të përhershëm, ndërkaq z. Kushtrim Shyti, është gjyqtar me mandat fillestar i emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me datë 31 korrik të vitit 2017. Ndërsa sa i përket mundësisë së transferimit të përkohshëm, KGJK konsideron se nuk ka rrethana të adresuara (jashtëzakonshme) për realizimin e domosdoshëm të këtij lloj transferi.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Skender COÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Kushtrim Shyti, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë;
- Kryetarës së Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë;
- Arkivit.